

VENDIM
Nr. 57, datë 24.2.2023

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s NË LIDHJE ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “TPLANI HC” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 99/11 prot., datë 23.2.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 14, datë 27.1.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kw.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 31.1.2023 dhe 1.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 9.2.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 99/6 prot., datë 7.2.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 99/7 prot., datë 9.2.2023, nr. 99/8 prot., datë 15.2.2023, si dhe nr. 99/9, datë 17.2.2023.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të zhvilluar një korrespondencë të mëtijshme me shoqërinë, me qëllim që të saktësohen me shoqërinë disa dokumente në kuadër të këtij aplikimi, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti